



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assembly

Komuna e Kaçanikut, në mbështetje të nenit 12 paragrafi 4 i Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve të veçanta, më datë 12.06.2019, shpallë :

K O N K U R S PËR MARRËVESHJE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA

I. Zyrtar për planifikim hapësinor

Drejtoria: Drejtoria për urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit

Paga mujore(bruto)- 430.00€

Numri i referencës së vendit të punës:01Nr. 111/01-16914/19

Detvrat dhe përgjegjësitë

1. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve përkatëse;
2. Kryen detyra të specializuara, sipas kërkesës në fushën profesionale specifike në përputhje me Ligjet, rregulloret, politikat dhe procedurat përkatëse, brenda afateve kohore të caktuara;
3. Bënë hulumtime dhe analiza profesionale sipas kërkesës dhe kontribon në hartimin e rekomandimeve për shqyrtim, dhënien e këshillave profesionale si dhe hartimin e dokumenteve tjera të nevojshme;
4. Merr pjesë në komisione apo grupe punuese në fushën profesionale specifike kur kërkohet një gjë e tillë;
5. Bashkëpunon me organet përkatëse brenda institucionit dhe jashtë tij lidhur me implementimin e planeve dhe projekteve komunale dhe zhvillimin e punës në fushat e interesit të përbashkët;
6. Raporton rregullisht të mbikëqyrësi rreth progresit në lidhje me planet e punës të miratuara;
7. Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe;

Procedura e konkurimit: është e hapur për të gjithë kandidatët e jashtëm .

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Përveç kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe kushtet e veçanta,

Shkollimi i kërkuar, Aftësitë, përvoja dhe attribute tjera që kërkohen:

- Diplomë universitare në arkitekturë
- Të ketë përvojë pune profesionale (e dëshirueshme)
- Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;
- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access, Internet).

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin: Përzgjedhja bëhet duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për shërbimin civil të Republikës së Kosovës duke zbatuar një procedurë të thjeshtësuar të rekrutimit.

Lloji i kontratës: “ Marrëveshje për shërbime të veçanta”

Kohëzgjatja e emërimit : Gjashtë (6) muaj

Data e mbylljes së konkursit; mbetet i hapur 7 ditë nga dita e publikimit, prej **12.06.2019** deri më **18.06.2019**.

Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar -Zyra e pranimit, kati përdhësë dhe në web-faqen komunale . Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten këto dokumente: Diplomen e Fakultetit të kryer apo kopjen e vërtetuar të diplomës, vërtetimin e përvojës së punës, certifikata mbi trajnimet e kryera ,kopjen e letërnjoftimit, certifikatën-ekstraktin e lindjes, dëshminë se nuk është në hetime.

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë” .

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, siç specifikohet në nenin 11, paragrafin 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për shërbimin civil të republikës së Kosovës. Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listen e ngushtë do të kontaktohen. Për çdo informacion kandidatët mund të kontaktojnë zyrën e personelit.

Kryetari i Komunës
Besim Ilazi